

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** Gjuhë shqipe

**Programi i studimit:** Teologji islame

**Numri i ECTS kredive:** 5

**Statusi i lëndës:** Obligative

**Kodi i lëndës:** 104

**Fondi i orëve:** 2+2

**Viti akademik:** 2026/2027

**Semestri:** I

**Ligjërues:** PhD (c) Besnik Jaha

**Detajet kontaktuese:** Tel:

Email: besnik.jaha@fsi-edu.net  
besnikjaha88@gmail.com

## Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Ky kurs ua mundëson studentëve plotësimin e njohurive për shqipen standarde dhe për drejtshkrimin, si dhe për problemet e gjuhës dhe historisë së saj, në përgjithësi, e sidomos ato të trajtuara së fundmi, në veçanti.

Ngritja e kulturës së gjuhës dhe e kulturës së drejtshkrimit, duke pasur parasysh pasurimin e fjalorit dhe shmangien e përdorimit të fjalëve të huaja është synim tjetër me rëndësi.

Po ashtu synohet edhe sjellja e njohurive plotësuese dhe thellimi në problemet e morfologjisë dhe njësisë të saj, si dhe çështje të foljes në gjuhën shqipe (kategoritë e saj - e kohës, e mënyrës dhe e vetës, me vëmendjen në qendër sidomos për foljet e parregullta).

Edhe ndërtimi i fjalisë, në secilin tip, si dhe tiparet kryesore dhe marrëdhëniet e ndryshme që ndërtohen brenda fjalisë së përbërë, pretendohet të arrihet përmes kësaj lënde.

## Qëllimi i lëndës:

Kursi Gjuha shqipe ka për qëllim që studentëve t'ua mundësojë njohjen e problemeve themelore të gjuhës shqipe, rifreskimin e njohurive që i kanë marrë gjatë shkollimit parauniversitar për gjuhën shqipe, për shqipen standarde dhe për logjikën që ka gramatika shqipe. Po ashtu si qëllim është edhe njohja e mirë e tipareve kryesore të shqipes standarde, dialekteve të shqipes, ashtu që njohuritë mbi gjuhën dhe gramatikën shqipe të zgjerohen në një shkallë më të thellë. Përmes kësaj synohen dy qëllime: i pari, përdorimi i drejt i standardit të shqipes, dhe; i dyti, ruajtja e shqipes nga ndikimet e huaja, meqë mes nesh vazhdimisht ka pasur vërshim të ndikimeve nga gjuhë të tjera, sidomos gjuhët sllave (serbishtja, maqedonishtja, bullgarishtja...), po edhe nga gjuhët e tjera, sikurse turqishtja, greqishtja, italishtja anglishtja e arabishtja. Këto ndikime i kanë shturur disa rregulla themelore të

ndërtimit të fjalisë dhe të njësive më të vogla sintaksore të shqipes, duke bërë që shqipja sot të shkruhet e tepërndikuar nga forma të huaja sintaksore. Po ashtu është qëllim edhe zhvillimi i aftësive shprehëse dhe i përdorimit të lirshëm të gjuhës në interpretimin e përmbajtjeve të çfarëdollojshme (edhe të materieve në fushën e shkencave teologjike), për t'u inkuadruar në procesin e komunikimit në nivelet më të larta – në diskutime shkencore e kulturore, debate e konferenca. Gjithsesi, qëllim final mbetet zotërimi i drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit në një shkallë sa më të mirë.

### **Rezultatet e pritura:**

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

- T'i njohin tiparet kryesore të shqipes standarde;
- T'i nxënë dhe t'i njohin rregullat kryesore të fonetikës, të morfologjisë dhe të sintaksës shqipe;
- T'i njohin mirë pjesët e ligjëratës, dhe të dinë t'i përdorin ato sipas frymës së gjuhës shqipe;
- Të zotërojnë në një masë të mirë rregullat e drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit të standardit;
- Të komunikojë me lehtësi dhe në një nivel të dëshirueshëm intelektual në standard;
- Të zotërojnë në një masë të mirë njohuritë leksikore;
- Ta zotërojnë terminologjinë teologjike në gjuhën shqipe, si dhe ta përdorë atë në interpretim dhe për probleme të ndryshme në këtë fushë;
- Të jenë të aftë të japin kontribut në përdorimin drejt të terminologjisë fetare sipas ligjeve të shqipes;
- Të jenë i gatshëm të marrin pjesë në debate kulturore, të ligjërojnë për çështje të besimit dhe të materies që kanë librat teologjikë;
- Ta zotërojnë shqipen aq sa për ta krahasuar me gjuhë të tjera në interpretime, komunikim dhe në sistem gramatikor.

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, të cilat do të zhvillohen përmes mjeteve konkretizuese, si dhe ushtrimeve dhe formave të stimulimit të studentëve-interaktivitet, për të diskutuar për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me lëndën.

### **PËRMBAJTJA E LËNDËS:**

#### **Java e parë:**

Njohja me objektin e lëndës dhe me literaturën obligative dhe atë shtesë.

Gjuha shqipe dhe origjina e saj.

Historia e shkrimit shqip.

Shtirirja e gjuhës shqipe dikur dhe sot (gjuha shqipe, gjuhë indo-evropiane).

#### **Java e dytë:**

Gjuha-gjuhësia në shkencat shoqërore.

Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar (gjuha, shkrimi dhe ligjërimi)

Gjuha dhe funksionet e saj

Ushtrime (detyra)

**Java e tretë:**

Gjuha shqipe dhe dialektet e saj (sociolektet dhe kronolektet).  
Gjuha letrare-standarde shqipe (gjuha e figurshme)  
Gjuha dhe disiplinat e saj, dhe lidhja mes tyre (Fonetika, Morfologjia, Sintaksa)  
Ushtrime (detyra)

**Java e katërt:**

Fonetika e gjuhës shqipe  
Klasifikimi i zanoreve,  
Diftongu, rrokja, intonacioni dhe theksi  
Ushtrime (detyra)

**Java e pestë:**

Morfologjia e shqipes (Struktura morfologjike e fjalës dhe tipat e fjalëformimit)  
Fjala dhe përbërësit e saj  
Klasat e fjalëve dhe ndarja e tyre  
Kategoritë gramatikore të fjalëve të ndryshueshme

**Java e gjashtë:**

Klasifikimi i emrave sipas tipit të lakimit  
Llojet e emrit dhe shkrimi i tyre  
Kategoritë gramatikore të emrit  
Lakimi i emrit

**Java e shtatë:**

Formimi i emrave dhe mënyra e fjalëformimit  
Formimi i emrave abstraktë dhe afektivë.  
Ushtrime (detyra)

**Java e tetë:**

Kategoritë gramatikore të mbiemrave (gjinisë, numrit, rasës, shkallës).  
Shkrimi i mbiemrave me prapashtesën “shëm” dhe “të”  
Takimi i shkronjave (zanoreve) të njëjta dhe të ndryshme

**Java e nëntë:**

Përemri dhe klasifikimi i përemrave.  
Lakimi i përemrave dhe përdorimet e trajtave të shkurtra  
Ushtrime drejtshkrimore (përdorimi i gabuar i përemrit vetor “unë” dhe “ti”)

**Java e dhjetë:**

Klasifikimi i foljeve sipas funksionit dhe kuptimit  
Kategoritë gramatikore të foljes, dhe zgjedhimi, mënyrat dhe kohët e foljes  
Foljet e parregullta dhe format e pashtjelluara të foljeve  
Metafonia dhe apofonia  
Ushtrime (detyra)

**Java e njëmbëdhjetë:**

Sintaksa shqipe (Gjymtyrët e kryesore dhe dytësore të fjalisë)  
Kryefjala dhe kallëzuesi  
Kundrinori; Rrethanori; Përcaktori

**Java e dymbëdhjetë:**

Fjalët e pandryshueshme dhe ndarja e tyre

Ndajfolja – klasifikimi i ndajfoljeve

Parafjala – klasifikimi i parafjalëve sipas prejardhjes

Lidhëza – klasifikimi i lidhëzave

Pjesëza dhe Pasthirrmat (shkrimi i drejtë i pasthirrmave përshëndetëse)

Numërori dhe shkrimi drejt i tij

**Java e trembëdhjetë:**

Njësitë sintaksore (fjalja, periudha, togfjalëshi, gjymtyrët e fjalisë).

Llojet e fjalisë pyetëse (Rotacioni Kryefjalë-Kallëzues)

Parimi fonetik dhe shkrimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe

**Java e katërbëdhjetë:**

Tipat e fjalive sipas llojit të kumtimit

Procesi i drejtshkrimit dhe parimet e shkrimit

Shkurtimi i fjalëve

Probleme të drejtshkrimit (shkrimi i fjalëve me shkronjë të madhe, foljet problematike...)

Ushtrime (detyra)

**Java e pesëmbëdhjetë:**

Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë

Shkrimi drejt i urimeve dhe i lutjeve dhe shkrimi i fjalëve me nistoret ç, sh, zh

Shkrimi drejt i fjalëve kur takohen shkronja “g” me shkronjën “j”

**Kriteret dhe mënyra e vlerësimit:**

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjërata 10%

Punim seminari (detyra) dhe botimi në periodikë 20%

Testi i ndërmjetëm 30%

Provimi final 40%

Total 100%

**Literatura e obligueshme:**

1. *Gramatika e gjuhës shqipe 1, Morfologjia*, Grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002
2. *Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaksa*, Grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002
3. Qemal Murati, *Gjuha e medieve (Fjalor i gabimeve gjuhësore)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008.
3. *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Ali Dhrimo & Rami Memushaj, Infobotues, Tiranë, 2011.
4. *Kulla e shqipes/Morfologjia digjitale*.

**Literatura shtesë-plotësuese:**

1. Rami Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Dituria, Tiranë, 2002.
2. Isa Bajçinca, Shqipja standarde dhe problemet rreth saj, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2016.
3. Nuhi Veselaj, Çështje të shqipes standarde (I, II, III), ERA, Prishtinë, 2017.
4. Zijadin Munishi, Zgjedhimi i foljeve, Artini, Prishtinë, 2013.
5. Xhevat Lloshi, Huazimet e shqipes nga turqishtja, Konica, Shkup, 2023.
6. Besnik Jaha, Distopia e Kadaresë, Bard Books, Prishtinë, 2024.
7. Rexhep Ismajli, Drejtshkrimet e shqipes, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2005.
8. Qemal Murati, Për kulturën gjuhësore shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2016.
9. Xhevdet Rusinovci, Si ta mësojmë shkrimin?, Bard Books, Prishtinë, 2024.
10. Qemal Morina, *GLOSAR I NOCIONEVE FETARE* (islame, ortodokse, katolike dhe çifute), Dituria Islame, Prishtinë, 2010.
11. Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.

### **Politikat akademike dhe kodi i mirësjelljes:**

Studentët janë të detyruar t'i ndjekin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet (në vazhdimësi do të mbahet evidencë). Gjithashtu studentët duhet të vijnë me kohë në ligjëratat, sepse vonesa e secilit shkakton çrregullim dhe shpërqendrim, e dëmton rrjedhjen e ligjërimit dhe të zhvillimit të ushtrimeve. Për orët e ushtrimeve studentët duhet t'i kryejnë detyrat sipas udhëzimeve të profesorit, e të cilat do të analizohen dhe do të vlerësohen, duke pasur ndikim edhe në vlerësimin e studentit sipas tabelës së kriterëve për vlerësim. Të gjithë studentët duhet t'i përfillin detyrimisht rregullat e mirësjelljes: qetësinë gjatë mësimit, shkyçjen e telefonave celularë etj.

### **Konsultimet:**

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet, sipas orarit të dhënë, dhe mund të shfrytëzohen për konsulta për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.